## REPUBLIKA E SHQIPERISE
## KUSHTETUTA E REPUBLIKES SE SHQIPERISE

**Ne, Populli i Shqiperise, krenare dhe te vetedijshem per historine tone, me pergjegjesi per te ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera te tjera universale, me vendosmeri per te ndertuar nje shtet te se drejtes, demokratik e social, per te garantuar te drejtat dhe lirite themelore te njeriut, me frymen e tolerances dhe te bashkejeteses fetare, me zotimin per mbrotjen e dinjitetit dhe te personalitetit njerezor, si dhe per prosperitet e te gjithe kombit, per paqen, mireqenien, kulturen dhe solidaritetin shoqeror, me aspiraten shekullore te popullit shqiptar per identitetin dhe bashkimin kombetar, me bindjen e thelle se drejtesia, paqja, harmonia dhe bashkepunimit ndermjet kombeve jane nder vlerat me te larta te njerezimit,**

Vendosim kete Kushtetute:

---

### PJESA E PARË : PARIME THEMELORE

Neni 1

1. Shqiperia eshte republike parlamentare.
2. Republika e Shqiperise eshte shtet unitar dhe i pandashem.
3. Qeverisja bazohet ne nje sistem zgjedhjesh te lira, te barabarta, te pergjithshme e periodike.

Neni 2

1. Sovraniteti ne Republiken e Shqiperise i perket popullit.
2. Populli e ushtron sovranitetin nepermjet perfaqsuesve te tij ose dreperdrejti
3. Per ruajtjen e paqes dhe te interesave kombetare, Republika e Shqiperise mund te. marre pjese ne nje sistem sigurimi kolektiv, ne baze te nje ligji te miratuar me shumicen e te gjithe anetarevete Kuvendit.

Neni 3

Pavaresia e shtetit dhe teresia e territorit te tij, dinjiteti i njeriut, te drejtat dhe lirite E tij, drejtesia shoqerore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombetar dhe trashegimia kombetare, bashkejetesa fetare, si dhe bashkejetesa dhe mirekuptimi i shqiptareve me pakicat jane baza e ketij shteti, i cili ka per detyre t'i respektoje dhe t'i mbroje.

Neni 4

1. E drejta perben bazen dhe kufijte e veprimtarise se shtetit.
2. Kushtetuta eshte ligji me i larte ne Republiken e Shqiperise.
3. Dispozitat e Kushtetutes zbatohen drejtpersedrejti, pervec rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Neni 5

Republika e Shqiperise zbaton te drejten nderkombetare te detyrueshme per te.

Neni 6

Organizimi dhe funksionimi i organeve te parashikuara ne kete Kushtetute rregullohen me ligjet e tyre perkatese, pervec rasteve kur ne Kushtetute parashikohet ndryshe.

Neni 7

Sistemi i qeverisjes ne republiken e Shqiperise bazohet ne ndarjen dhe balancimin
Ndermjet pushteteve ligjvenes, ekzekutiv dhe gjyqesor.

Neni 8

1. Republika e Shqiperise mbron te drejtat kombetare te popullit shqiptar qe jeton jashte kufijveve te saj.
2. Republika e Shqiperise mbron te drejtat e shtetasve shqiptare me banim te Perkohshem ose te te perhershem jashte kufijve te vet.
3. Republika e Shqiperise u siguron ndihme shtetasve shqiptare qe jetojne e punojne jashte shtetit per te ruajtur e per te zhvilluar lidhjet me trashegimine kulturore kombetare.

Neni 9

1. Partite politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet te perputhet me parimet demokratike.
2. Partite politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e te cilave mbeshteten ne metodat totalitariste, qe nxitin e perkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, qe perdorin dhunen per marrjen e pushtetit ose per te ndikuar ne politiken shteterore, si edhe ato me karakter te fshehte jane te ndaluara sipas ligjit.
3. Burimet financiare te partive, si dhe shpenzimet e tyre behen kurdohere publike.

Neni 10

1. Ne Republiken e Shqiperise nuk ka fe zyrtare.
2. Shteti eshte asnjanes ne ceshtjet e besimit e te ndergjegjes dhe garanton lirine e shprehjes se tyre ne jeten publike.
3. Shtetinjeh barazine e bashkesive fetare.
4. Shteti dhe bashkesite fetare respektojne ne menyre te ndersjellte pavaresine e njeri-tjetrit dhe bashkepunojne ne te mire te secilit dhe te te gjitheve.
5. Marredheniet ndermjet shtetit dhe bashkesive fetare rregullohen mbi bazen e marreveshjeve te lidhura ndermjet perfaqsuesve te tyre dhe Keshillit te Ministrave. Keto marreveshje ratifikohen ne Kuvend.
6. Bashkesite fetare jane persona juridike. Ato kane pavaresi ne administrimin e pasurive te tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve te tyre, per sa nuk cenohen interesat e te treteve.

Neni 11

1. Sistemi ekonomik i Republikes se Shqiperise bazohet ne pronen private e publike, si dhe ne ekonomine e tregut dhe ne lirine e veprimtarise ekonomike.
2. Prona private dhe publike mbrohen njelloj me ligj.
3. Kufizime te lirise se veprimtarise ekonomike mund te vendosen vetem me ligj dhe vetem per arsye te rendesishme publike.

Neni 12

1. Forcat e armatosura sigurojne pavaresine e vendit, si dhe mbrojne teresine territoriale dhe rendin e tij kushtetues.
2. Forcat e armatosura ruajne asnjanesine ne ceshtjet politike dhe i nenshtrohen kontrollit civil.
3. Asnje force e huaj ushtarake nuk mund te vendoset dhe as te kaloje ne territorin Shqiptar, si dhe asnje force ushtarake shqiptare nuk mund te dergohet jashte, pervecse me nje ligj te miratuar me shumicen e te gjithe anetareve te Kuvendit.

Neni 13

Qeverisja vendore ne Republiken e Shqiperise ngrihet ne baze te parimit te
decentralizmit te pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit te autonomise vendore.

Neni 14

1. Gjuha zyrtare ne Republiken e Shqiperise eshte shqipja.
2. Flamuri kombetar eshte i kuq me nje shqiponje te zeze dykrenore ne mes.
3. Stema e Republikes se Shqiperise paraqet nje shqyt me fushe te kuqe me nje Shqiponje te zeze dykrenore ne mes. Ne krye te

shqytit, me ngjyre te arte, eshte vendosur perkrenarja e Skenderbeut.
4. Himni kombetar eshte "Rreth Flamurit te Perbashkuar".
5. Festa Kombetare e Republikes se Shqiperise eshte Dita e Flamurit, 28 Nentori.
6. Kryeqyteti i Republikes se Shqiperise eshte Tirana.
7. Forma dhe permasat e simboleve kombetare, permbajtaja e tekstit te himnit Kombetar, si dhe perdorimi i tyre rregullohen me ligj.

---

## PJESA E DYTË: TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT

### KREU I: PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 15

1. Te drejtat dhe lirite themelore te njeriut jane te pandashme, te patjetersueshme e te Padhunueshme dhe qendrojne ne themel te te gjithe rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, ne permbushje te detyrave te tyre, duhet te respektojne te drejtat dhe lirite themelore te njeriut, si dhe te kontribuojne ne realizimin e tyre.

Neni 16

1. Te drejtat e lirite themelore, si dhe detyremet e parashikuara ne Kushtetute per shtetasit shqiptare vlejne njelloj edhe per te huajt e per personat pa shtetesine territorin e Republikes se Shqiperise, me perjashtim te rasteve kur Kushtetuta e lidh ne menyre te posacme me shtetesine shqiptare ushtrimin e te drejtave e te lirive te caktuara.
2. Te drejtat dhe lirite themelore, si dhe detyremet e parashikuara ne Kushtetute vlejne edhe per personat juridike, per aq sa perputhen me qellimet e pergjithshme te ketyre personave dhe me thelbin e ketyre te drejtave, lirive dhe detyremeve.

Neni 17

1. Kufizime te te drejtave dhe lirive te parashikuar ne kete Kushtetute mund te vendosen vetem me ligj per nje interes publik ose per mbrotjen e te drejtave te te tjereve. Kufizimi duhet te jete ne perpjesetim me gjendjen qe e ka diktuar ate.
2. Keto kufizime nuk mund te cenojne thelbin e lirive dhe te te drejtave dhe ne asnje rast nuk mund te tejkalojne kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Te gjithe jane te barabarte perpara ligjit.
2. Askush nuk mund te diskriminohet padrejtesisht per shkaqe te tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesia prinderore.
3. Askush nuk mund te diskriminohet per shkaqet e permendura ne paragrafin 2, nese nuk ekziston nje perligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 19

1. Kushdo qe lind duke pasur qofte edhe njerin prej prinderve me shtetesi shqiptare, e fiton vetiu shtetesine shqiptare. Shtetesia shqiptare fitohet edhe per shkaqe te tjera te parashikuara me ligj.
2. Shtetasi shqiptar nuk mund ta humbase shtetesine, pervecse kur ai heq dore prej saj.

Neni 20

1. Personat qe u perkasinpakicave kombetare ushtrojne ne barazi te plote para ligjit te drejtat dhe lirite e tyre.
2. Ata kane te drejte te shprehin lirisht, pa u ndalur as detyruar, perkatesine e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhesore. Ata kane te drejte t'i ruajne e zhvillojne ato, te mesojne dhe te mesohen ne gjuhen e tyre amtare, si dhe te bashkohen ne organizata e shoqata per mbrotjen e interesave dhe te identitetit te tyre.

**KREU II: LIRITË DHE TË DREJTAT VETJAKE**

Neni 21

Jeta e personit mbrohet me ligj.

Neni 22

1. Liria e shprehjes eshte e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit eshte e garantuar.
3. Censura paraprake e mjeteve te komunikimit ndalohet.
4. Ligji mund te kerkoje dhenien e autorizimit per funksionimin e stacioneve te radios.

Neni 23

1. E drejta e informimit eshte e garantuar.
2. Kushdo ka te drejte, ne perputhje me ligjin, te marre informacion per veprimtarine e organeve shteterore, si dhe te personave qe ushtrojne funksione shteterore.
3. Kujtdo i jepet mundesia te ndjeke mbledhjet e organeve te zgjedhura kolektive.

Neni 24

1. Liria e ndergjegjes dhe e fese eshte e garantuar.
2. Secili eshte i lire te zgjedhe ose te ndryshoje fene ose bindjet, si dhe t'i shfaqe ato individualisht ose kolektivisht, ne publik ose ne ne jeten private, nepermjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes se riteve.
3. Askush nuk mund te detyrohet ose te ndalohet te marre pjese ne nje bashkesi fetare ose ne praktikat e saj, si dhe te beje publike bindjet ose besimin e tij.

Neni 25

Askush nuk mund t'i neshtrohet tortures, denimit apo trajtimit mizor, cnjerezor ose poshterues.

Neni 26

Askujt nuk mund t'i kerkohet te kryeje nje pune te detyruar, pervecse ne rastet e ekzekutimit te nje vendimi gjyqesor, te kryejes se sherbimit ushtarak, te nje sherbimi qe rrjedh nga nje gjendje lufte, nga nje gjendje e jashtezakonshme ose nga nje fatkeqesi natyrore, qe kercenon jeten ose shtetesine e njerezve.

Neni 27

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, pervecse ne rastet dhe sipas procedurave te Parashikuara me ligj.
2. Liria e personit nuk mund te kufizohen, pervecse ne rastet e meposhtme:
a) kur eshte denuar me burgim nga gjykata kompetente;
b) per moszbatimte urdhrave te ligjshem te gjykates ose per moszbatim te ndonje detyrimi te caktuar me ligj.
c) kur ka dyshime te arsyshme se ka kryer nje veper penale ose per te parandaluar kryerjen prej tij te vepres penale ose largimin e tij pas kryerjes se saj.
ç) per mbikeqyrjen e te miturit per qellime edukimi ose per shoqerimin e tij ne organin kompetent .
d) kur personi eshte perhapes i nje semundje ngjitese, i paafte menderisht dhe i rrezikshem per shoqerine.
dh) per hyrje te paligjshme ne kufirin shteteror, si dhe ne rastet e debimit ose te ekstradimit.
3. Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetem per shkak se nuk eshte ne gjendje te Permbushe nje detyrim kotraktor.

Neni 28

1. Kushdo, te cilit i hiqet liria, ka te drejte te njoftohet menjehere ne gjuhen qe ai kupton, per shkaqet e kesaj mase, si dhe per akuzen

qe i behet. Personi, te cilit i eshte hequr liria, duhet te njoftohet se nuk ka asnje detyrim te beje ndonje deklarate dhe ka te drejte te komunikoje menjehere me avokatin, si dhe t'i jepet mundesia per realizimin e te drejtave te tij.
2. Personi, te cilit i eshte hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nenparagrafi c, duhet te dergohet brenda 48 oreve perpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo me vone se 48 ore nga casti i marrjes se dokumenteve per shqyrtim.
3. I paraburgosuri ka te drejte te ankohet kunder vendimit te gjyqtarit. Ai ka te drejte te gjykohet brenda nje afati te arsyeshem ose te procedohet i lire perkundrejt nje garancie pasurore sipas ligjit.
4. Ne te gjitha rastet e tjera, personi, te cilit i hiqet liria ne rruge jashtegjyqesore, mund t'i drejtohet ne cdo kohe gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 oreve per ligjshmerine e kesaj mase.
5. Çdo person, te cilit i eshte hequr liria sipas nenit 27, ka te drejten e trajtimit njerezor dhe te respektimit te dinjitetit te tij.

Neni 29

1. Askush nuk mund te akuzohet ose te deklarohet fajtor per nje veper penale, e cila nuk konsiderohej e tille me ligj ne kohen e kryerjes se saj, me perjashtim te veprave, te cilat ne e kryerjes se tyre, perbenin krime lufte ose krime kunder njerezimit sipas se drejtes nderkombetare.
2. Nuk mund te jepet nje denim me i rende se ai qe ka qene parashikuar me ligj ne kohen e kryerjes se vepres penale.
3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.

Neni 30

Kushdo quhet i pafajshem perderisa nuk i eshte provuar fajesia me vendim gjyqesor te formes se prere.

Neni 31

Gjate proçesit penal kushdo ka te drejte:
a) te vihet ne dijeni menjehere dhe hollesisht per akuzen qe i behet, per te drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundesia per te njoftuar familjen ose te afermit e tij.
b) te kete kohen dhe lehtesite e mjaftueshme per te pergatitur mbrotjen e vet;
c) te kete ndihmen pa pagese te nje perkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhen shqipe;
ç) te mbrohet vete ose me ndihmen e nje mbrojtesi ligjor te zgjedhur prej tij; te komunikoje lirisht dhe privatisht me te, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete te mjaftueshme;
d) t'u beje pyetje deshmitareve te pranishem dhe te kerkoje paraqitjen e deshmitareve, te eksperteve dhe te personave te tjere, te cilet mund te sqarojne faktet.

Neni 32

1. Askush nuk mund te detyrohet te deshmoje kunder vetvetes ose familjes se vet dhe as te pohoje fajesine e tij.
2. Askush nuk mund te deklarohet fajtor mbi bazen e te dhenave te mbledhura ne menyre te paligjshme.

Neni 33

1. Kushdo ka te drejte te degjohet para se te gjykohet.
2. Nga kjo e drejte nuk mund te perfitoje personi qe i fshihet drejtesise.

Neni 34

Askush nuk mund te denohet me shume se nje here per te njejten veper penale dhe as te gjykohet serish, me perjashtim te rasteve kur eshte vendosur rigjykimi i ceshtjes nga nje gjykate me e larte, sipas menyres se parashikuar me ligj.

Neni 35

1. Askush nuk mund te detyrohet, pervecse kur e kerkon ligji, te beje publike te dhena qe Lidhen me personin e tij.
2. Mbledhja, perdorimi dhe berja publike e te dhenave rreth personit behet me pelqimin e tij me perjashtim te rasteve te parashikuara me ligj.
3. Kushdo ka te drejte te njihet me te dhenat e mbledhura rreth tij, me perjashtim te rasteve te parashikuara me ligj.
4. Kushdo ka te drejte te kerkoje ndreqjen ose fshirjen e te dhenave te paverteta ose te paplota ose te mbledhura ne kundershtim me ligjin.

Neni 36

Liria dhe fshehtesia e korrespondences ose e cdo mjeti tjeter te komunikimit jane te garantuara.

Neni 37

1. Paprekshmeria e baneses eshte e garantuar.
2. Kontrollet e baneses, si dhe te mjediseve qe njesohen me te, mund te behen vetem ne rastet dhe ne menyrat e parashikuara me ligj.
3. Askujt nuk mund t'i behet kontroll vetjak jashte procesit penal, me perjashtim te rasteve te hyrjes ne territorin e shtetit dhe te daljes prej tij ose per te menjanuar nje rrezik qe i kanoset sigurimit publik.

Neni 38

1. Kushdo ka te drejte te zgjedhe vendbanimin si dhe te levize lirisht ne cdo pjese te territorit te shtetit.
2. Askush nuk mund te pengohet te dale lirisht jashte shtetit.

Neni 39

1. Asnje shtetas shqiptar nuk mund te debohet nga territori i shtetit.
2. Ekstradimi mund te lejohet vetem kur eshte parashikuar shprehimisht ne marreveshjet nderkombetare ne te cilat Republika e Shqiperise eshte pale, dhe vetem me vendim gjyqesor.
3. Ndalohet debimi kolektiv i te huajve. Debimi i individeve te huaj lejohet ne kushtet e Percaktuara me ligj.

Neni 40

Te huajt kane te drejten e strehimit ne Republiken e Shqiperise sipas ligjit.

Neni 41

1. E drejta e prones private eshte e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashegimi, me blerje dhe me cdo menyre tjeter klasike te parashikuar ne Kodin Civil.
3. Ligji mund te parashikoje shpronesime ose kufizime ne ushtrimin e se drejtes se prones vetem per interesa publike.
4. Shpronesimet ose ato kufizime te se drejtes se prones qe barazohen me shpronesimin, lejohen vetem perkundrejt nje shperblimi te drejte.
5. Per mosmarreveshjet lidhur me masen e shperblimit mund te behet ankim ne gjykate.

Neni 42

1. Liria, prona dhe te drejtat e njohura me Kushtetute dhe me ligj nuk mund te cenohen pa nje proces te rregullt ligjor.
2. Kushdo, per mbrojtjen e te drejtave, te lirive dhe te interesave te tij kushtetues dhe ligjore, ose ne rastin e akuzave te ngritura kunder tij, ka te drejten e nje gjykimi te drejte dhe publik brenda nje afati te arsyeshem nga nje gjykate e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 43

Kushdo ka te drejte te ankohet kunder nje vendimi gjyqesor ne nje gjykate me te larte, pervecse kur ne Kushtetute parashikohet ndryshe.

Neni 44

Kushdo ka te drejte te rehabilitohet dhe/ose te zhdemtohet ne perputhje me ligjin, ne rast se eshte demtuar per shkak te nje akti, veprimi ose mosveprimi te paligjshem te organeve shteterore.

---

**KREU III: LIRITE DHE TË DREJTAT POLITIKE**

Neni 45

1. Cdo shtetas qe ka mbushur tetembedhjete vjec, qofte edhe diten e zgjedhjeve, ka te drejten te zgjedhe dhe te zgjidhet.
2. Perjashtohen nga e drejta e zgjdhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqesor te formes se prere si te paafte menderisht
3. Te denuarit qe jane duke vuajtur denimin me heqje te lirise, kane vetem te drejten per te zgjedhur.
4. Vota eshte vetjake, e barabarte, e lire dhe e fshehte.

Neni 46

1. Kushdo ka te drejte te organizohet kolektivisht per cfaredo qellimi te ligjshem.
2. Regjestrimi ne gjykate i organizatave ose i shoqateve behet sipas procedures se parashikuar me ligj.
3. Organizatat ose shoqatat qe ndjekin qellime antikushtetuese jane te ndaluara sipas ligjit.

Neni 47

1. Liria e tubimeve paqesore dhe pa arme, si dhe e pjesemarrjes ne to eshte e garantuar.
2. Tubimet paqesore ne sheshe dhe ne vendet e kalimit publik behen sipas procedurave te parashikuara me ligj.

Neni 48

Kushdo, vete ose se bashku me te tjere, mund t'u drejtoje kerkesa, ankesa me verejtje organeve publike, te cilat jane te detyruara te pergjigjen ne afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

---

**KREU IV: LIRITË DHE TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE**

Neni 49

1. Secili ka te drejte te fitoje mjetet e jeteses se tij me pune te ligjshme, qe e ka zgjedhur ose pranuar vete. Ai eshte i lire te zgjedhe profesionin, vendin e punes, si dhe sistemin e kualifikimit te vet profesional.
2. Te punesuarit kane te drejen e mbrojtjes shoqerore te punes.

Neni 50

Te punesuarit kane te drejte te bashkohen lirisht ne organizata sindikale per mbrojtjen e interesave te tyre te punes.

Neni 51

1. E drejta e te punesuarit per grve qe ka te beje me marredheniet e punes, eshte e garantuar.
2. Kufizime per kategori te vecanta te punesuarish mund te vendosen me ligj per t'i siguruar shoqerise sherbimet e domosdoshme.

Neni 52

1. Kushdo ka te drejten e sigurimeve shoqerore ne pleqeri ose kur eshte i paafte per pune, sipas nje sistemi te caktuar me ligj.
2. Kushdo, kur mbetet pa pune per shkaqe te pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete te tjera jetese, ka te drejten e ndihmes ne kushtet e parashikuara me ligj.

Neni 53

1. Kushdoka te drejte te martohet dhe te kete familje.
2. Martesa familja gezojne mbrojtjen e vecante te shtetit.

3. Lidhja dhe zgjidhja e marteses rregullohen me ligj.

Neni 54

1. Femijet, te rinjte, grate shtatzena dhe nenat e reja kane te drejten e nje mbrojtjeje te vecante nga shteti.
2. Femijet e lindur jashte martese kane te drejta te barabarta me te lindurit nga martesa.
3. Çdo femije ka te drejte te jete i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytezimi dhe perdorimi per pune, e vecanerisht nen moshen minimale per punen e femijeve, qe mund te demtoje shendetin, moralin ose te rrezikoje jeten a zhvillimin e tij normal.

Neni 55

1. Shtetasit gezojne ne menyre te barabarte te drejten per kujdes shendetesor nga shteti.
2. Kushdo ka te drejte per sigurim shendetesor sipas procedures se caktuar me ligj.

Neni 56

Kushdo ka te drejte te informohet per gjendjen e mjedisit dhe per mbrojtjen e tij.

Neni 57

1. Kushdo ka te drejten per arsimim.
2. Arsimi shkollor i detyrueshem caktohet me ligj.
3. Arsimi i mesem i pergjithshem publik eshte i hapur per te gjithe.
4. Arsimi i mesem profesional dhe i larte mund te kushtezohet vetem nga kritere aftesie.
5. Arsimi i detyrueshem, si dhe arsimi i mesem i pergjithshem ne shkollat publike eshte falas.
6. Nxenesit dhe studentet mund te arsimohen edhe ne shkolla jopublike te te gjitha niveleve, te cilat krijohen e funksionojne ne baze te ligjit.
7. Autonomia e institucioneve te arsimit te larte dhe liria akademike jane te garantuara me ligj.

Neni 58

1. Liria e krijimit artistik dhe e kerkimit shkencor, venia ne perdorim si dhe perfitimi prej arritjeve te tyre jane te garantuara per te gjithe.
2. E drejta e autorit mbrohet me ligj.

---

## KREU V: OBJEKTIVAT SOCIALË

Neni 59

1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe ne plotesim te nismes dhe te pergjegjesise private, synon:
a) punesimin ne kushte te pershtatshme te te gjithe personave te afte per pune;
b) plotesimin e nevojave te shtetsave per strehim;
c) standartin me te larte shendetesor, fizik e mendor, te mundshem;
ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftesive te femijeve dhe te te rinjve, si dhe te personave te pazene me pune;
d) nje mjedis te shendetshem dhe ekologjikisht te pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem;
dh) shfytezimin racional te pyjeve, ujerave, kullotave dhe burimeve te tjera natyrore mbi bazen e parimit te zhvillimit te qendrueshem;
e) perkujdesjen dhe ndihmen per te moshuarit, jetimet dhe invalideve;
e) zhvillimin e sportit dhe te veprimtarive riperteritese;
f) riaftesimin shendetesor, edukimin e specializuar dhe integrimin ne shoqeri te te paafteve, si dhe permiresimin ne vazhdimesi te kushteve te tyre te jeteses;
g) mbrojtjen e trashegimise kombetare kulturore dhe kujdesin e vecante per gjuhen shqipe.
2. Permbushjae objektivave sociale nuk mund te kerkohet drejtperdrejt ne gjykate. Ligji percakton kushtet dhe masen ne te cilat mund te kerkohet realizimi i ketyre objektivave.

**KREU VI: AVOKATI I POPULLIT**

Neni 60

1. Avokati i Popullit mbron te drejtat, lirite dhe interesat e ligjshem te individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e te parregullta te organeve te administrates publike.
2. Avokati i Popullit eshte i pavarur ne ushtrimin e detyres se tij.
3. Avokati i Popullit ka buxhet te vecante, te cilin e administron vete. Ai e propozon buxhetin sipas ligjit.

Neni 61

1. Avokati i Popullit zgjidhet nga tri te pestat e te gjithe anetareve te Kuvendit per nje periudhe prej 5 vjetesh, me te drejte rizgjedhje.
2. Avokati i Popullit mund te jete cdo shtetas shqiptar, me arsim te larte, me njohuri dhe veprimtari te njohura ne fushen e te drejtave te njeriut dhe te ligjit.
3. Avokati i Popullit gezon imunitetin e gjyqtarit te Gjykates se Larte.
4. Avokati i Popullit nuk mund te beje pjese ne asnje parti politike, nuk mund te kryeje veprimtari tjeter politike, shteterore ose profesionale dhe as te marre pjese ne organizmat drejtues te organizatave shoqerore, ekonomike dhe tregtare.

Neni 62

1. Avokati i Popullit mund te shkarkohet vetem me kerkese te motivuar te jo me pak se nje se tretes se deputeteve.
2. Ne kete rast Kuvendi vendos me tri te pestat e te gjithe anetareve te tij.

Neni 63

1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor perpara Kuvendit.
2. Avokati i Popullit raporton perpara Kuvendit kur i kerkohet prej ketij, si dhe mund t'i kerkoje Kuvendit te degjohet per ceshtje qe ai cmon te rendesishme.
3. Avokati i Popullit kate drejte te beje rekomandime dhe te propozoje masa kur veren shkelje te te drejtave dhe lirive te njeriut nga administrata publike.
4. Organet dhe funksionaret publike jane te detyruar t'i paraqesin Avokatit te Popullit te gjitha dokumentet dhe informacionet e kerkuara prej tij.

---

**PJESA E TRETE: KUVENDI**

**KREU I: ZGJEDHJA DHE AFATI**

Neni 64

1. Kuvendi perbehet nga 140 deputete. 100 deputete zgjidhen drejtperdrejt ne zona njeemerore me numerte perafert zgjedhesish. 40 deputete zgjidhen nga listat shumeemerore te partive dhe/ose koalicioneve te partive sipas renditjes ne to.
2. Numri i pergjithshem i deputeteve te cdo partie dh/ose koalicionipartish percaktohet ne raport sa me te afert me votat e vlefshme te marra prej tyre ne te gjithe vendin ne raundin e pare te zgjedhjeve.
3. Partite qe marrin me pak se 2.5 per qind dhe koalicionet e partive qe marrin me pak se 4 per qind te votave te vlefshme ne te gjithe vendin ne raudnin e pare te zgjedhjeve nuk perfitojne nga listat shumeemerore perkatese.

Neni 65

1. Kuvendi zgjidhet per kater vjet.
2. Zgjedhjet per Kuvendin zhvillohen 60 deri ne 30 dite para mbarrimit te mandatit dhe jo me vone se 45 dite pas shperndarjes se tij.
3. Mandati i Kuvendit vazhdon deri ne mbledhjen e pare te Kuvendit te ri. Ne kete nderkohe Kuvendi nuk mund te nxjerre ligje ose te marre vendime, me perjashtim te rasteve te vendosjes se masave te jashtezakonshme.

Neni 66

Mandati i Kuvendit zgjatet vetem ne rast lufte dhe per aq kohe sa vazhdon ajo.Kur Kuvendi eshte i shperndare, ai rithirret vetiu.

Neni 67

1. Kuvendi i porsazgjedhur thirret ne mbledhjen e pare nga Presidenti i Republikes jo me vone se 20 dite nga perfundimi i zgjedhjeve.
2. Ne rast se Presidenti i Republikes nuk e ushtron kete kompetence, Kuvendi duhet te mblidhet vete brenda 10 diteve nga mbarimi i afatit te parashikuar ne paragrafin 1 te ketij neni.

---

**KREU II: DEPUTETET**

Neni 68

1. Kandidatet per deputete mund te paraqiten vetem nga partite politike, nga koalicionet e partive, si dhe nga zgjedhesit.
2. Rregullat per caktimin e kandidateve per deputete, per organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, si dhe percaktimi i zonave zgjedhore dhe kushtet e vlefshmerise se zgjedhjeve rregullohen nga ligji per zgjedhjet.

Neni 69

1. Nuk mund te kandidoje e as te zgjidhen deputete, pa hequr dore nga detyra:
a) gjyqtaret, prokuroret;
b) ushtaraket e sherbimit aktiv;
c) punonjesit e policise dhe te sigurimit kombetar;
ç) perfaqesuesit diplomatik;
d) kryetaret e bashkive dhe te komunave, si dhe prefektet ne vendet ku kryejne detyrat e tyre;
dh) kryetaret dhe anetaret e komisioneve te zgjedhjeve;
e) Presidenti i Republikes dhe funksionaret e larte te administrates shteterore te parashikuara nga ligji.
2. Mandati i fituar ne kundershtim me paragrafin 1 te ketij neni eshte i pavlefshem.

Neni 70

1. Deputetet perfaqesojne popullin dhe nuk lidhen me asnje mandat detyrues.
2. Deputetet nuk mund te ushtrojne njekohesisht asnje detyre tjeter shteterore, pervec asaj te anetarit te Keshillit te Ministrave. Rastet e tjera te papajtueshmerise caktohen me ligj.
3. Deputetet nuk mund te kryejne asnje veprimtari fitimprurese qe buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as te fitojne pasuri te ketyre.
4. Per cdo shkelje te paragrafit 3 te ketij neni, me mocion te kryetarit te Kuvendit ose te nje se dhjetes se anetareve te tij, Kuvendi vendos per dergimin e ceshtjes ne Gjykaten Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmerine.

Neni 71

1. Mandati i deputetit fillon diten qe ai shpallet i zgjedhur nga komisioni perkates i zgjedhjeve.
2. Mandati i deputetit mbaron ose eshte i pavlefshem, sipas rastit:
a) kur ai nuk ben betimin;
b) kur heq dore nga mandati;
c) kur vertetohet nje nga kushtet e pazgjedhshmerise ose papajtueshmerise te parashikuara ne nenet 69, 70 paragrafet 2 dhe 3;
ç) kur mbaron mandati i Kuvendit;
d) kur mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht ne Kuvend;
dh) kur denohet me vendim gjyqesor te formes se prere per kryerjen e nje krimi.

Neni 72

Para fillimit te ushtrimit te mandatit deputet bejne betimin ne Kuvend.

Neni 73

1. Deputeti nuk mban pergjegjesi per mendimet e shprehura ne Kuvend dhe per votat e dhena prej tij. Kjo dispozite nuk zbatohet ne rastin e shpifjes.
2. Deputeti nuk mund te ndiqet penalisht pa autorizimin e Kuvendit. Autorizimi kerkohet edhe ne rastin kur ai do te arrestohet.
3. Deputeti mund te ndalohet ose te arrestohet pa autorizim kur kapet ne kryerje e siper ose menjehere pas kryerjes se nje krimi te rende. Ne keto raste, Prokurori i Pergjithshem njofton menjehere Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend per procedim, vendos per heqjen e mases.
4. Per rastet e parashikuara ne paragrafet 2 dhe 3 te ketij neni, Kuvendi vendos me votim te fshehte .

---

## KREU III: ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 74

1. Kuvendi i zhvillon punimet vjetore ne dy sesione. Sesioni i pare fillon te henen e trete te janarit dhe sesioni i dyte te henen e pare te shtatorit.
2. Kuvendi mblidhet ne sesion te jashtezakonshem, kur kerkohet nga Presidenti i Republikes, nga Kryeministri ose nga nje e pesta e te gjithe deputeteve.
3. Sesionet e jashtezakonsheme thirren nga Kryetari i Kuvendit ne baze te nje rendi dite te percaktuar.

Neni 75

1. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet.
2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores se miratuar nga shumica e te gjithe anetareve.

Neni 76

1. Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e te drejtave te Kuvendit dhe te anetareve te tij, si dhe perfaqeson Kuvendin ne marredheniet me te tjeret.
2. Nepunesit me i larte civil i Kuvendit eshte sekretari i pergjithshem.
3. Sherbimet e tjera te nevojshme per funksionimin e Kuvendit kryhen nga nepunes te tjere, sic percaktohet ne rregulloren e brendshme.

Neni 77

1. Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione te perhershme, si dhe mund te caktoje komisione te posacme.
2. Kuvendi ka te drejte dhe, me kerkese te nje se katertes se te gjithe anetareve te tij, eshte i detyruar te caktoje komision hetimi per te shyrtuar nje ceshtje te vecante. Perfundimet e tyre nuk jane detyruese per gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorise, e cila i vlereson sipas procedures ligjore.
3. Komisionet e hetimit veprojne sipas procedures se parashikuar me ligj.

Neni 78

1. Kuvendi vendos me shumicen e votave, ne prani te me shume se gjysmes se te gjithe anetareve te tij, pervec rasteve kur Kushtetuta parashikon nje shumice te cilesuar.
2. Mbledhjet e deputeteve qe mbahen pa uthirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnje pasoje.

Neni 79

1. Mbledhjet e Kuvendit behen te hapura.
2. Me kerkesen e Presidentit te Republikes, te Kryeministrit ose te nje se pestes se deputeteve mbledhjet e Kuvendit mund te behen te mbyllura, kur per kete kane votuar shumica e te gjithe anetareve te tij.

Neni 80

1. Kryeministri dhe cdo anetar tjeter i Keshillit te Ministrave eshte i detyruar t'u pergjigjet interpelancave dhe pyetjeve te deputeteve brenda tri javeve.
2. Anetari i Keshillit te Ministrave ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Kuvendit ose te komisioneve te tij; atij i jepet fjala sa here qe e kerkon.
3. Drejtuesit e institucioneve shteterore, me kerkese te komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojne per ceshtje te ndryshme te veprimtarise se tyre per sa e lejon ligji.

---

**KREU IV: PROCESI LIGJVENES**

Neni 81

1. Te drejten per te propozuar ligje e ka Keshilli i Ministrave , cdo deputet, si dhe 20 mije zgjedhes.
2. Miratohen me tri te pestat e te gjithe anetareve te Kuvendit:
a) ligjet per organizimin dhe funksionimin e institucioneve, te parashikuara nga Kushtetuta;
b) ligji per shtetesine;
c) ligji per zgjedhjet e pergjithshme dhe vendore;
ç) ligji per referendumet;
d) kodet;
dh) ligji per gjendjen e jashtezakonshme;
e) ligji per statusin e funksionareve publike;
w) ligji per amnistine;
f) ligji per ndarjen administrative te Republikes.

Neni 82

1. Propozimi i ligjeve, kur eshte rasti, duhet te shoqerohet kurdohere me raportin qe perligj shpenzimetfinanciare per zbatimin e tij.
2. Asnje projektligj joqeveritar qe ben te nevojshme rritjen e shpenzimeve te buxhetit te shtetit ose qe pakeson te ardhurat, nuk mund te miratohet pa marre mendimin e Keshillit te Ministrave, i cili duhet te shprehet brenda 30 diteve nga data e marrjes se projektligjit.
3. Ne qofte se Keshilli i Ministrave nuk shprehet brenda afatit te mesiperm, projektligji kalon per shqyrtim sipas procedures se zakonshme.

Neni 83

1. Projektliggji votohet tri here: ne parim, nen per nen dhe ne teresi.
2. Kuvendi, me kerkese te Keshillit te Ministrave ose te nje se pestes se te gjithe deputeteve, mund te shqyrtoje e te miratoje nje projekt ligj me procedure te pershpejtuar, por jo me pare se nje jave nga fillimi i procedures se shqyrtimit.
3. Procedura e pershpejtuar nuk lejohet per shqyrtimin e projektligjeve te parashikuara ne nenin 81 paragrafi 2, me perjashtim te nenparagrafit dh.

Nenin 84

1. Presidenti i Republikes shpall ligjin e miratuar brenda 20 diteve nga paraqitja e tij.
2. Ligji quhet i shpallur, ne qofte se Presidenti i Republikes nuk ushtron te drejtat e parashikuara ne paragrafin 1 te ketij neni dhe ne paragrafin 1 te nenit 85.
3. Ligji hyn ne fuqi me kalimin e jo me pak se 15 diteve nga botimi i tij ne Fletoren Zyrtare.
4. Ne rastet e masave te jashtezakonshme, si dhe ne rast nevoje e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicen e te gjithe anetareve dhe Presidenti i Rpublikes jep pelqimin, ligji hyn ne fuqi menjehere, vetem pasi te jete njoftuar publikisht. Ligji duhet te botohet ne numrin me te pare te Fletores Zyrtare.

Neni 85

1. Presidenti i Republikes ka te drejte taktheje ligjin per rishqyrtim vetem nje here.
2. Dekreti i Presidentit per rishqyrtimin e nje ligji e humbet fuqine, kur kunder tij votojne shumicave e te gjithe anetareve te Kuvendit.

**PJESA E KATERT: PRESIDENTI I REPUBLIKES**

Neni 86

1. Presidenti i Republikes eshte Kryetar i Shtetit dhe perfaqson unitetin e popullit.
2. Presidenti mund te zgjidhet vetem shtetasi shqiptar qe nga lindja, me qendrim jo me pak se 10 vjetet e fundit ne Shqiperi dhe qe ka mbushur moshen 40 vjec.

Neni 87

1. Kandidati per President i propozohet Kuvendit nga nje grup prej jo me pak se 20 deputetesh. Nje deputet nuk lejohet te marre pjese ne me shume se nje grup propozues.
2. Presidenti i Republikes zgjidhet me votim te fshehte dhe pa debat nga Kuvendi me nje shumice prej tri te pestave te te gjithe anetareve te tij.
3. Kur ne votimin e pare nuk arrihet kjo shumice, brenda 7 diteve nga kryerja e votimit te pare behet nje votim i dyte.
4. Ne rast se edhe ne votimin e dyte nuk arrihet kjo shumice, brenda 7 diteve behet nje votim i trete.
5. Kur ka me shume se dy kandidate dhe asnjeri prej tyre nuk ka marre shumicen e kerkuar, brenda 7 diteve behet nje votim i katert ndermjet dy kandidateve qe kane marre numrin numrin me te madh te votave.
6. Ne rast se edhe ne votimin e katert asnjeri prej dy kandidateve nuk ka marre shumicen e kerkuar, behet nje votim i peste.
7. Ne rast se edhe pas votimit te peste asnjeri prej dy kandidateve nuk ka marre shumicen e kerkuar, Kuvendi shperndahet dhe brenda 60 diteve behen zgjedhjet e reja te pergjithshme.
8. Kuvendi i ri zgjedh Presidentin sipas procedures se parashikuar nga paragrafet 1 deri ne 7 te ketij neni. Ne rast se edhe Kuvendi i ri nuk e zgjedh Presidentin, ai shperndahet dhe brenda 60 diteve behen zgjedhje te reja te pergjithshme.
9. Kuvendi pasardhes zgjedh Presidentin e Republikes me shumicen e te gjithe anetareve te tij.

Neni 88

1. Presidenti i Republikes, ne cdo rast, zgjidhet per 5 vjet, me te drejte rizgjedhjeje vetem nje here.
2. Procedura per zgjedhjen e Presidentit fillon jo me vone se 30 dite para mbarimit te mandatit presidencial paraardhes.
3. Presidenti fillon ne detyre pasi ben betimin para Kuvendit, por jo me pare se te kete mbaruar mandati i Presidentit qe largohet. Presidenti ben kete betim:
"Betohem se do t'i bindem Kushtetutes dhe ligjeve te vendit, do te respektoj te drejtat dhe lirite e shtetasve, do te mbroj pavaresine e Republikes se Shqiperise dhe do t'i sherbej interesit te pergjithshem dhe perparimit te Popullit Shqiptar." Presidenti mund te shtoje edhe :"Zoti me ndihmofte!"
4. Presidenti qe jep dorehеqjen para mbarimit te mandatit te vet, nuk mund te kandidoje ne zgjedhjen presidenciale qe behet pas doreheqjes se tij.

Neni 89

Presidenti i Republikes nuk mund te mbaje asnje detyre tjeter publike, nuk mund te jete anetar partie dhe as te kryeje veprimtari tjeter private.

Neni 90

1. Presidenti i Republikes nuk ka pergjegjesi per aktet e kryera ne ushtrim te detyres se tij.
2. Presidenti i Republikes mund te shkarkohet per shkelje te rende te Kushtetutes dhe per kryerjen e nje krimi te rende. Propozimi per shkarkimin e Presidentit ne keto raste mund te behet nga jo me pak se nje e katerta e anetareve te Kuvendit dhe duhet te mbeshtetet nga jo me pak se dy te tretat e te gjithe anetareve te tij.
3. Vendimi i Kuvendit i dergohet Gjykates Kushtetuese, e cila kur verteton fajesine e Presidentit te Republikes , deklaron shkarkimin e tij nga detyra.

Neni 91

1. Kur Presidenti i Republikes eshte ne pamundesi te perkohshme per te ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit ze vendin dhe ushtron kompetencat e tij.
2. Ne rast se Presidenti nuk mund te ushtroje detyren per me shume se 60 dite, Kuvendi, me dy te tretat e te gjithe anetareve, vendos dergimin e ceshtjes ne Gjykaten Kushtetuese, e cila verteton perfundimisht faktin e pamundesise. Ne rast te vertetimit te pamundesise, vendi i Presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e Presidentit te ri fillon brenda 10 diteve nga dita e vertetimit te

pamundesise.

Neni 92

Presidenti ushtron edhe keto kompetenca:
a) i drejton mesazhe Kuvendit;
b) ushtron te drejten e faljes sipas ligjit;
c) jep shtetesine shqiptare dhe lejon lenien e saj sipas ligjit;
ç) jep dekorata e tituj nderi sipas ligjit;
d) jep gradat me te larta ushtarake sipas ligjit;
dh) me propozim te Kryeministrit, emeron dhe liron perfaqesuesit e plotfuqishem te Republikes se Shqiperise ne shtetet e tjera dhe ne organizatat nderkombetare.
e) pranon letrat kredenciale dhe terheqjen e perfaqesuesve diplomatike te shteteve te tjera dhe te organizatave nderkombetare te akredituara ne Republiken e Shqiperise.
e) lidh marreveshje nderkombetare sipas ligjit;
f) me propozim te Kryeministrit, emeron drejtorin e sherbimit informativ te shtetit;
g) emeron Kryetarin e Akademise se Shkencave dhe rektoret e universiteteve sipas ligjit;
gj) cakton daten e zgjedhjeve per Kuvendin, per organet e pushtetit vendor dhe per zhvillimin e referendumeve;
h) kerkon mendim dhe te dhena me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shteterore per ceshtje qe kane te bejne me detyrat e tyre.

Neni 93

Presidenti i Republikes, ne zbatim te kompetencave te tij, nxjerr dekrete.

Neni 94

Presidenti i Republikes nuk mund te ushtroje kompetenca te tjera pervec atyre qe i njihen shprehimisht me Kushtetute dhe qe i jepen me ligje te nxjerra ne pajtim me te.

---

## PJESA E PESTE: KESHILLI I MINISTRAVE

Neni 95

1. Keshilli i Ministrave perbehet nga Kryeministri , zevendeskryeministri dhe ministrat.
2. Keshilli i Ministrave ushtron cdo funksion shteteror, i cili nuk u eshte dhene organeve te pushteteve te tjera shteterore ose te qeverisjes vendore.

Neni 96

1. Presidenti i Republikes, ne fillim te legjislatures, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emeron Kryeministrin me propozim te partise ose koalicionit te partive, qe ka shumicen e vendeve ne Kuvend.
2. Ne qofte se Kryeministri i emeruar nuk miratohet nga Kuvendi, Presidenti emeron nje Kryeminister te ri brenda 10 diteve.
3. Ne qofte se edhe Kryeministri i emeruar rishtas nuk miratohet nga Kuvendi, brenda 10 diteve Kuvendi zgjedh nje Kryeminister tjeter. Ne kete rast Presidenti emeron Kryeministrin e ri.
4. Kur Kuvendi nuk arrin te zgjedhe Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikes shperndan Kuvendin.

Neni 97

Kryeministri i emeruar sipas nenit 96, nenit104 ose 105, i paraqet per miratim Kuvendit, brenda 10 diteve, programin politik te Keshillit te Ministrave se bashku me perberjen e tij.

Neni 98

1. Ministri emerohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikes, me propozim te Kryeministrit, brenda 7 diteve.
2. Dekreti shqyrtohet brenda 10 diteve nga Kuvendi.

Neni 99

Para fillimit te detyres, Kryeministri, zevendeskryeministri dhe ministrat betohen para Presidentit te Republikes.

Neni 100

1. Keshilli i Ministrave percakton drejtimet kryesore te politikes se pergjithshme shteterore.
2. Keshilli i Ministrave merr vendime me propozim te Kryeministrit ose te ministrit perkates.
3. Mbledhjet e Keshillit te Ministrave behen te mbyllura.
4. Aktet e Keshillit te Ministrave jane te vlefshme, kur nenshkruhen nga Kryeministri dhe ministri propuzues.
5. Keshilli i Ministrave nxjerr vendime dhe udhezime.

Neni 101

Keshilli i Ministrave , ne rast nevoje dhe urgjence, nen pergjegjesine e tij, mund te nxjerre akte normative qe kane fuqine e ligjit, per marrjen e masave te perkohshme. Keto akte normative i dergohen menjehere Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 diteve nese nuk eshte i mbledhur. Keto akte humbasin fuqine qe nga fillimi, ne qofte se nuk miratohen nga kuvendi brenda 45 diteve.

Neni 102

1. Kryeministri:
a) perfaqeson Keshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjen e tij;
b) koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore te politikes se pergjithshme shteterore dhe pergjigjet per to;
c) siguron zbatimin e legjislacionit dhe te politikave te miratuara nga Keshilli i Ministrave;
ç) bashkerendon dhe kontrollon punen e anetareve te Keshillit te Ministrave dhe te institucioneve te tjera te administrates qendrore te shtetit;
d) kryen detyra te tjera te parashikuara ne Kushtetute e ne ligje.
2. Kryeministri zgjidh mosmarreveshjet ndermjet miknistrave.
3. Kryeministri, ne zbatim te kompetencave te tij,nxjerr urdhra.
4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore te politikes se pergjithshme shteterore, drejton nen pergjegjesine e tij veprimtarine qe ka ne kompetence. Ministri, ne zbatim te kompetencave te tij,nxjerr urdhra dhe udhezime.

Neni 103

1. Minister mund te caktohet kushdo qe ka cilesineper deputet.
2. Ministri nuk mund te ushtroje asnje veprimtari tjeter shteterore dhe as te jete drejtues ose anetar i organeve te shoqerive fitimprurese.
3. Anetaret e Keshillit te Ministrave gezojne imunitetin e deputetit.

Neni 104

1. Ne rast se mocioni i besimit i paraqitur nga Kryeministri refuzohet nga shumica e te gjithe anetareve te Kuvendit, Kuvendi, brenda 15 diteve, zgjedh nje Kryeminister tjeter. Ne kete rast Presidenti emeron Kryeministrin e ri.
2. Kur Kuvendi nuk arrin te zgjedhe Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikes shperndan Kuvendin.
3. Votimi i mocionit nuk mund te behet pa kaluar 3 dite nga paraqitja e tij.

Neni 105

1. Ne rast se mocioni i mosbesimit i paraqitur nga nje e pesta e deputeteve miratohet nga shumica e te gjithe anetareve e te Kuvendit, Kuvendi, brenda 15 diteve, zgjedh nje Kryminister tjeter. Ne kete rast Presidenti emeron Kryeministrin e ri.
2. Kur kuvendi nuk arrin te zgjedhe Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikes shperndan Kuvendin.
3. Votimi i mocionit nuk mund te behet pa kaluar 3 dite nga paraqitja e tij.

Neni 106

Kryeministri dhe ministrat jane te detyruar te qendrojne ne detyre deri ne formimin e Keshillit te Ministrave pasardhes.

Neni 107

1. Nepunesit publike zbatojne ligjin edhe jane ne sherbim te popullit.
2. Nepunesit ne administraten publike caktohen me konkurs, me perjashtim te rasteve te parashikuara nga ligji.
3. Garancite e qendrimit ne detyre dhe trajtimi ligjor i nepunesve publike rregullohen me ligj.

---

**PJESA E GJASHTE: QEVERISJA VENDORE**

Neni 108

1. Njesite e qeverisjes vendore jane komunat ose bashkite dhe qarqet. Njesi te tjera te qeverisjes vendore rregullohen me ligj.
2. Ndarjet administrative-territoriale te njesive te qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazen e nevojave e te interesave te perbashket ekonomike dhe te tradites historike. Kufijte e tyre nuk mund te ndryshohen pa u marre me pare mendimi i popullsise qe banon ne to.
3. Komuna dhe bashkia jane njesi baze te qeverisjes vendore. Ato kryejne te gjitha detyrat veteqeverisese, me perjashtim te atyre qe me ligj u jepen njesive te tjera te qeverisjes vendore.
4. Veteqeverisja ne njesite vendore ushtrohet nepermjet organeve te tyre perfaqesuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat per zhvillimin de referendumit vendor parashikohet me ligj ne perputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2.

Neni 109

1. Organet perfaqesuese te njesive baze te qeverisjes vendore jane keshillat, te cilet zgjidhen cdo tre vjet me zgjedhje te pergjithshme, te drejtperdrejta dhe me votim te fshehte .
2. Organi ekzekutiv i bashkise ose i komunes eshte kryetari, i cili zgjidhet dreperdrejt nga populli ne menyren e parashikuar ne paragrafin 1 te ketij neni.
3. Te drejten e zgjedhjes ne keshillat vendore dhe si kryetar bashkie ose komune e kane vetem shtetasit qe jane me banim te perhershem ne territorin e njesive vendore perkatese.
4. Organet e njesive te qeverisjes vendore kane te drejte te formojne bashkime dhe institucione te perbashketa me njeri- tjetrin per perfaqesimin e interesave te tyre, te bashkepunoje me njesite vendore te vendeve te tjera, si dhe te perfaqesohen ne organizatat nderkombetare te pushteteve vendore.

Neni 110

1. Qarku perbehet nga disa njesi baze te qeverisjes vendore me lidhje tradicionale, ekonomike e sociale dhe te interesave te perbeshketa.
2. Qarku eshte njesia ku ndertohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politiken shteterore.
3. Organi perfaqesues i qarkut eshte keshilli i qarkut. Bashkite dhe komunat delegojne anetare ne keshillin e qarkut ne perpjesetim me popullsine e tyre, por per cdo rast te pakten nje anetar. Kryetaret e komunave dhe te bashkive jane kurdohere anetare te keshillit te qarkut. Anetaret e tjere te tij zgjidhen me lista perpjestimore nder keshilltaret bashkiake ose komunale nga keshillat perkates.
4. Keshilli i qarkut kate drejte te nxjerre urdheresa dhe vendime me fuqi detyruese te pergjithshme per qarkun.

Neni 111

1. Njesite e qeverisjes vendore jane persona juridike.
2. Njesite e qeverisjes vendore kane buxhet te pavarur, i cili krijohet ne menyren e parashikuar me ligj.

Neni 112

1. Njesive te qeverisjes vendore mund t'u delegohen me ligj kompetenca te administrates shteterore . Shpenzimet qe kryhen per ushtrimin e delegimit, perballohen nga shteti.
2. Organeve te qeverisjes vendore mund t'u vihen detyreme vetem ne perputhje me ligjin ose sipas marreveshjeve qe ato lidhin. Shpenzimet qe lidhen me detyrimet qe u vihen me ligj organeve te qeverisjes vendore perballohen nga buxheti i shtetit.

Neni 113

1. Keshillat komunale, bashkiake dhe te qarkut:
a) rregullojne dhe administrojne ne menyre te pavarur ceshtjet vendore brenda juridiksionit te tyre;
b) ushtrojne te drejtat e prones, administrojne ne menyre te pavarur te ardhurat e krijuara, si dhe kane te drejte te ushtrojne veprimtari ekonomike;
c) kane te drejte te mbledhin dhe te shpenzojne te ardhurat qe jane te domosdoshme per ushtrimin e funskioneve te tyre;
ç) kane te drejte te vendosin, ne perputhje me ligjin, taksa vendore, si dhe nivelin e tyre;
d) caktojne rregullat per organizimin dhe funksionimin e tyre ne pajtim me ligjin ;
dh) krijojne simbolet e qeverisjes vendore, si dhe titujt vendore te nderit;
e) ndermarrin nisma per ceshtje vendore perpara organeve te caktuara me ligj;
2. Organet e njesive te qeverisjes vendore nxjerrin urdheresa, vendime dhe urdhra.
3. Te drejtat per veteqeverisje te njesive te qeverisjes vendore mbrohen ne gjykate.

Neni 114

Keshilli i Ministrave cakton prefektin si perfaqesues te tij ne cdo qark. Kompetencat e prefektit caktohen me ligj.

Neni 115

1. Organi i zgjedhur drejtperdrejt i njesive qeverisese vendore mund te shperndahet ose te shkarkohet nga Keshilli i Ministrave per shkelje te renda te Kushtetutes ose te ligjeve.
2. Organi i shperndare ose i shkarkuar mund te ankohet ne Gjykaten Kushtetuese brenda 15 diteve, dhe ne kete rast vendimi i Keshillit te Ministrave pezullohet.
3. Ne rastin e mosushtrimit te se drejtes se ankimit brenda 15 diteve, ose ne rastin e lenies ne fuqi te vendimit te Keshillit te Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikes cakton daten e zgjedhjeve ne njesine vendore perkatese.

---

## PJESA E SHTATE: AKTET NORMATIVE DHE MARREVESHJET NDERKOMBETARE

### KREU I: AKTET NORMATIVE

Neni 116

1. Aktet normative qe kane fuqi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise jane:
a) Kushtetuta;
b) marreveshjet nderkombetare te ratifikuara;
c) ligjet;
ç) aktet normative te Keshillit te Ministrave.
2. Aktet qe nxirren nga organet e pushtetit vendor kane fuqi vetem brenda juridiksionit territorial qe ushtrojne keto organe.
3. Aktet normative te ministrave dhe te organeve drejtuese te institucioneve te tjera qendrore kane fuqi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise brenda sferes se juridiksionit te tyre.

Neni 117

1. Ligjet, aktet normative te Keshillit te Ministrave, te ministrave, te institucioneve te tjera qendrore marrin fuqi juridike vetem pasi botohen ne Fletoren Zyrtare.
2. Shpallja dhe botimi i akteve te tjera normative behet sipas menyres se parashikuar me ligj.
3. Marreveshjet nderkombetare qe ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave qe parashikohen per ligjet. Shpallja dhe botimi i marreveshjeve te tjera nderkombetare behet sipas ligjit.

Neni 118

1. Aktet nenligjore nxirren ne baze dhe per zbatim te ligjeve nga organet e parashikuara ne Kushtetute.

2. Ligji duhet te autorizoje nxjerrjen e akteve nenligjore, te percaktoje organin kompetent, ceshtjet qe duhen rregulluar, si dhe parimet ne baze te te cilave nxirren keto akte.
3. Organi i autorizuar me ligj per te nxjerre akte nenligjore, sic specifikohet ne paragrafin 2 te ketij neni, nuk mund t'ia delegoje kompetencen e tij nje organi tjeter.

Neni 119

1. Rregulloret e Keshillit te Ministrave, te ministrive e te institucioneve te tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, te ministrave e te drejtuesve te institucioneve qendrore kane karakter te brendshem dhe jane te detyrueshme vetem per njesite administrative qe varen prej tyre.
2. Keto akte nxirren ne baze te ligjit dhe nuk mund te sherbejne si baze per te marre vendime ne lidhje me individet dhe subjektet e tjera.
3. Rregulloret dhe urdhrat nxirren ne baze dhe per zbatim te akteve qe kane fuqi juridike te pergjitshme.

Neni 120

Parimet dhe procedurat per nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj.

---

## KREU II: MARREVESHJET NDERKOMBETARE

Neni 121

1. Ratifikimi dhe denoncimi i marreveshjeve nderkombetare nga Republika e Shqiperise behet me ligj ne rastet kur ato kane te bejne me:
a) territorin, paqen, aleancat, ceshtjet politike dhe ushtarake;
b) te drejtat dhe lirite e njeriut,si edhe detyrimet e shtetasve , sic parashikon ne Kushtetute:
c) anetaresimin e Republikes se Shqiperise ne organizatat nderkombetare;
ç) marrjen persiper te detyrimeve financiare nga Republika e Shqiperise;
d) miratimin, ndryshimin, plotesimin ose shfuqizimin e ligjeve.
2. Kuvendi, me shumicen e te gjitheve anetareve, mund te ratifikoje dhe marreveshje te tjera nderkombetare qe nuk parashikohen ne paragrafin 1 te ketij neni.
3. Kryeministri e njofton Kuvendin sa here qe Keshilli i Ministrave nenshkruan nje marreveshje nderkombetare qe nuk ratifikohet me ligj.
4. Parimet dhe procedurat per ratifikimin dhe ratifikimin dhe denoncimin e marreveshje nderkombetare parashikohen me ligj.

Neni 122

1. Cdo marreveshje nderkombetare e ratifikuar perben pjese te sistemit te brendshem juridik pasi botohet ne Fletoren Zyrtare te Republikes se Shqiperise. Ajo zbatohet ne menyre te drejtperdrejte,pervec rasteve kur nuk eshte e vetezbatueshme dhe zbatimi i saj kerkon nxjerrjen e nje ligji. Ndryshimi, plotesimi dhe shfuqizimi i ligjeve te miratuara me shumicen e te gjithe anetareve te Kuvendit per efekt te ratifikimit te marreveshjeve nderkombetare behet me te njejten shumice.
2. Nje marreveshje nderkombetare e ratifikuar me ligj ka epersi mbi ligjet e vendti qe nuk pajtohen me te.
3. Normat e nxjerra prej nje organizate nderkombetare kane epersi, ne rast konflikti , mbi te drejten e vendit, kur ne marreveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqiperise per pjesemarrjen ne ate organizate, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtperdrejte i normave te nxjerra prej saj.

Neni 123

1. Republika e Shqiperise, ne bazete marreveshjeve nderkombetare, u delegon organizatave nderkombertare kompetenca shteterore per ceshtje te caktuara.
2. Ligji me te cilin ratifikohet nje marreveshje nderkombetare, sic parashikohet ne paragrafin 1 te ketij neni, miratohet me shumicen e te gjithe anetareve te Kuvendit.
3. Kuvendi mund te vendose qe ratifikimi i nje marreveshjeje te tille te behet me referendum.

**PJESA E TETE : GJYKATA KUSHTETUESE**

Neni 124

1. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutes dhe ben interpretimin perfundimtar te saj.
2. Gjykata Kushtetuese i nenshtrohet vetem Kushtetutes.

Neni 125

1. Gjykata Kushtetuese perbehet nga 9 anetare, te cilet emerohen nga Presidenti i Republikes me pelqimin e Kuvendit.
2. Gjyqtaret emerohen per 9 vjet, pa te drejte riemerimi, nga radhet e juristeve me kualifikim te larte dhe me pervoje pune jo me pak se 15 vjet ne profesion.
3. Perberja e Gjykates Kushtetuese perterihet cdo tre vjet ne nje te treten e saj sipas procedures se caktuar me ligj.
4. Kryetari i Gjykates Kushtetuese emerohet nga radhet e anetareve te saj nga Presidenti i Republikes, me pelqimin e Kuvendit, per nje periudhe prej 3 vjetesh.
5. Gjyqtari i Gjykates Kushtetuese vazhdon ne detyre deri ne emerimin e pasardhesit te tij.

Neni 126

Gjyqtari i Gjykates Kushtetuese nuk mund te ndiqet penalisht pa pelqimin e Gjykates Kushtetuese. Gjyqtari i Gjykates Kushtetuese mund te ndalohet ose te arrestohet vetem ne qofte se kapet ne kryerje e siper te nje krimi ose menjehere pas kryerjes se tij. Organi kompetent njofton menjehere Gjykaten Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pelqimin brenda 24 oreve per dergimin ne gjykate te gjyqtarit te arrestuar , organi kompetent eshte i detyruar ta liroje ate.

Neni 127

1. Mandati i gjyqtarit te Gjykates Kushtetuese mbaron kur:
a) denohet me vendim te formes se prere per kryerjen e nje krimi;
b) nuk paraqitet pa arsye ne detyre per me shume se 6 muaj;
c) mbush moshen 70 vjec;
ç) jep doreheqjen;
d) me vendim gjyqesor te formes se prere deklarohet i paafte per te vepruar.
2. Mbarimi i mandatit te gjyqtarit deklarohet me vendim te Gjykates Kushtetuese.
3. Ne rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, Presidenti i Republikes emeron, me pelqimin e Kuvendit, nje gjyqtar te ri, i cili qendron ne detyre deri ne perfundimin e mandatit te gjyqtarit te larguar.

Neni 128

Gjyqtari i Gjykates Kushtetuese mund te shkarkohet nga Kuvendi me dy te tretat e te gjithe anetareve te tij per shkelje te Kushtetutes, per kryerjen e nje krimi, per paaftesi mendore a fizike, per akte e sjellje qe diskretitojne rende poziten dhe figuren e gjyqtarit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila, kur verteton se ekziston nje nga shkaqet e mesiperme, deklaron shkarkimin nga detyra te anetarit te Gjykates Kushtetuese.

Neni 129

Gjyqtari i Gjykates Kushtetuese fillon detyren pasi ben betimin para Presidentit te Republikes.

Neni 130

Qenia gjyqtar i Gjykates Kushtetuese nuk pajtohet me asnje veprimtari tjeter shteterore, politike ose private.

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos per:
a) pajtueshmerine e ligjit me Kushtetuten ose me marreveshjet nderkombetare, sic parashikohet ne nenin 122;
b) pajtueshmerine e marreveshjeve nderkombetare me Kushtetuten para ratifikimit te tyre;
c) pajtueshmerine e akteve normative te organeve qendrore dhe vendore me Kushtetuten dhe me marreveshjet nderkombetare;
ç) mosmarreveshjet e kompetences ndermjet pushteteve, si dhe ndermjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;
d) kushtetueshmerine e partive dhe te organizatave te tjera politike, si dhe te veprimtarise se tyre, sipas nenit 9 te kesaj Kushtetute;
dh) shkarkimin nga detyra te Presidentit te Republikes dhe vertetimin e pamundesise se ushtrimit te funksioneve te tij;
e) ceshtjet qe lidhen me zgjedhshmerine dhe papajtueshmerite ne ushtrimin e funksioneve te Presidentit te Republikes dhe te deputeteve, si dhe me verifikimin e zgjedhjes se tyre;
e) kushtetueshmerine e referendumit dhe verifikimin e rezultateve te tij;
f) gjykimin perfundimtar te ankesave te individeve per shkeljen e te drejtave te tyre kushtetuese per nje proces te rregullt ligjor, pasi te jene shteruar te gjitha mjetet juridike per mbrojtjen e ketyre te drejtave.

Neni 132

1. Vendimet e Gjykates Kushtetuese kane fuqi detyruese te pergjithshme dhe jane perfundimtare. Gjykata Kushtetuese ka vetem te drejten e shfuqizimit te akteve qe shqyrton.
2. Vendimet e Gjykates Kushtetuese hyjne ne fuqi diten e botimit ne Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund te vendose qe ligji ose akti tjeter normativ te shfuqizohet ne nje date tjeter. Mendimi i pakices botohet bashke me vendimin.

Neni 133

1. Pranimi i ankesave per gjykim vendoset nga nje numer gjyqtaresh, sic percaktohet me ligj.
2. Gjykata Kushtetuese vendos me shumicen e te gjithe anetareve te saj.

Neni 134

1. Gjykata Kushtetuese vihet ne levizje vetem me kerkese te:
a) Presidenti te Republikes;
b) Kryeministrit;
c) jo me pak se nje te pestes se deputeteve;
ç) Kryetarit te Kontrollit te Larte te Shtetit;
d) çdo gjykate sipas rastit te nenit 145 pika 2 te kesaj Kushtetute;
dh) Avokatit te Popullit;
e) organeve te qeverisjes vendore;
w) organeve te bashkesive fetare;
f) partive politike dhe organizatave te tjera;
g) individeve.
2. Subjektet e parashikuara nga nenparagrafet dh, e , e, f dhe g te paragrafit 1 te ketij neni mund te bejne kerkese vetem per ceshtje qe lidhen me interesat e tyre.

---

**PJESA E NENTE: GJYKATAT**

Neni 135

1. Pushteti gjyqesor ushtrohet nga Gjykata e Larte, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkalles se pare, te cilat krijohen me ligj.
2. Kuvendi mund te krijoje me ligj gjykata per fusha te vecanta, por ne asnje rast gjykata te jashtezakonshme.

Neni 136

1. Anetaret e Gjykates se Larte emerohen nga Presidenti i Republikes me pelqimin e Kuvendit.
2. Njeri nga anetaret emerohet Kryetar sipas procedures se parashikuar ne paragrafin 1 te ketij neni.
3. Kryetari dhe anetaret e Gjykates se Larte qendrojne ne detyre per 9 vjet pa te drejte riemerimi.
4. Gjyqtaret e tjere emerohen nga Presidenti i Republikes me propozim te Keshillit te Larte te Drejtesise.

5. Gjyqtaret mund te jene vetem shtetasit me arsim te larte juridik. Kushtet dhe procedura e zgjedhjes caktohen me ligj.

Neni 137

1. Gjyqtari i Gjykates se Larte mund te ndiqet penalisht vetem me miratimin e Kuvendit.
2. Gjyqtari i Gjykates se Larte mund te ndalohet ose te arrestohet vetem ne qofte se kapet ne kryerje e siper te nje krimi ose menjehere pas kryerjes se tij. Organi kompetent njofton menjehere Gjykaten Kushtetuese nuk jep pelqimin brenda 24 oreve per dergimin ne gjykate te gjyqtarit te arrestuar, organi kompetent eshte i detyruar ta liroje ate.
3. Gjyqtaret e tjere mund te ndiqen pebalisht vetem me miratim te Keshillit te Larte te Drejtesise.
4. Gjyqtari mund te ndalohet ose te arrestohet vetem ne qofte se kapet ne kryerje e siper te nje krimi ose menjehere pas kryerjes se tij. Organi kompetent njofton menjehere Keshillin e Larte te Drejtesise. Ne qofte se Keshilli i Larte i Drejtesise nuk jep pelqimin brenda 24 oreve per dergimin ne gjykate te gjyqtarit te arrestuar, organi kompetent eshte i detyruar ta liroje ate.

Neni 138

Koha e qendrimit te gjyqtareve ne detyre nuk mund te kufizohet; paga dhe perfitimet e tjera nuk mund te ulen.

Neni 139

1. Mandati i gjyqtarit te Gjykates se Larte mbaron kur:
a) denohet me vendim gjyqesor te formes se prere per kryerjen e nje krimi;
b) nuk paraqitet ne detyre pa arsye per me shume se 6 muaj;
c) mbush moshen 65 vjec;
ç) jep doreheqjen;
d) deklarohet i paafte per te vepruar me vendim gjyqesor te formes se prere.
2. Mbarimi i mandatit te gjyqtarit deklarohet me vendim te Gjykates se Larte.

Neni 140

Gjyqtari i Gjykates se Larte mund te shkarkohet nga Kuvendi me dy te tretat e te gjithe anetareve te tij per shkelje te Kushtetutes, per kryerjen e nje krimi, per paaftesi mendore a fizike dhe per akte e sjellje qe diskreditojne rende poziten dhe figuren e gjyqtarit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila, kur verteton se ekziston nje nga shkaqet e mesiperme, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.

Neni 141

1. Gjykata e Larte ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kunder Presidentit, Kryetari dhe anetareve te Keshillit te Ministrave,deputeteve gjyqtareve te Gjykates se Larte dhe gjyqtareve te Gjykates Kushtetuese.
2. Per njesimin ose ndryshimin e praktikes gjyqesore, Gjykata e Larte ka te drejte te terheqe per shqyrtim ne kolegjet e bashkuara ceshtje te caktuara gjyqesore.

Neni 142

1. Vendimet gjyqesore duhet te jene te arsyetura.
2. Gjykata e Larte duhet t'i botoje vendimet e saj, si dhe mendimet e pakices.
3. Organet e shtetit jane te detyruara te ekzekutojne vendimet gjyqesore.

Neni 143

Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnje veprimtari tjeter shteterore, politike ose private.

Neni 144

Gjykatat kane buxhet te vecante, te cilin e administojne vete. Ato e propozojne buxhetin e tyre sipas ligjit.

Neni 145

1. Gjyqtaret jane te pavarur dhe u nenshtrohen vetem Kushtetutes dhe ligjeve.
2. Kur gjyqtaret cmojne se ligjet vijne ne kundershtim me Kushtetuten, nuk i zbatojne ato. Ne kete rast, ata pezullojne gjykimin dhe ia dergojne ceshtjen Gjykates Kushtetuese. Vendimet e Gjykates Kushtetuese jane te detyrueshme per te gjitha gjykatat.
3. Nderhyrja ne veprimtarine e gjykatave ose te gjyqtareve passjell pergjegjesi sipas ligjit.

Neni 146

1. Gjykatat i japin vendimet ne emer te Republikes.
2. Vendimet gjyqesore shpallen publikisht ne cdo rast.

Neni 147

1. Keshilli i Larte i Drejtesise perbehet nga Presidenti i Republikes, Kryetari i Gjykates se Larte, ministri i Drejtesise, 3 anetare te zgjedhur nga Kuvendi, si dhe 9 gjyqtare te te gjitha niveleve, te cilet zgjidhen nga Konferenca Gjyqesore Kombetare. Anetaret e zgjedhur qendrojne ne detyreper 5 vjet pa te drejte rizgjedhjeje te menjehershme.
2. Presidenti iRepublikes eshte Kryetar i Keshillit te Larte te Drejtesise.
3. Keshilli i Larte i Drejtesise, me propozim te Presidentit, zgjedh nga radhet e tij nje zevendeskryetar. Zevendeskryetari organizon veprimtarine e Keshillit te Larte te Drejtesise, si dhe kryeson mbledhjet e tij ne mungese te Presidentit te Republikes.
4. Keshilli i Larte i Drejtesise vendos per transferimin e gjyqtareve, si dhe per pergjegjesine e tyre disiplinore sipas ligjiy.
5. Transferimi i gjyqtareve nuk mund te behet pa pelqimin e tyre, pervecse kur kete e diktojne nevojat e riorganizimit te sistemit gjyqesor.
6. Gjyqtari mund te shkarkohet nga Keshilli i Larte i Drejtesise per kryerjen e nje krimi, per paaftesi mendore a fizike, per akte e sjellje qe diskretitojne rende poziten dhe figuren e gjyqtarit ose per pamjaftueshmeri profesionale. Kubder ketij vendimi gjyqtari ka te drejte te ankohet ne Gjykaten e Larte, e cila ne kete rast, vendos me kolegje te bashkuara.

---

**PJESA E DHJETE: PROKURORIA**

Neni 148

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe perfaqeson akuzen ne gjyq ne emer te shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra te tjera te caktuara me ligj.
2. Prokuroria jane te organizuar dhe funksionojne prane sistemit gjyqesor si nje organ i centralizuar.
3. Ne ushtrimin e kompetencave te tyre prokuroret u nenshtrohen Kushtetutes dhe ligjev.

Neni 149

1. Prokurori i Pergjithshem emerohet nga Presidenti i Republikes me pelqimin e Kuvendit.
2. Prokurori i Pergjithshem mund te shkarkohet nga Presidenti i Republikes, me propozim te Kuvendit, per shkelje te Kushtetutes ose per shkelje te renda te ligjit gjate ushtrimit te funksioneve te tij, per paaftesi mendore a fizike, per akte e sjellje qe diskretitojne rende poziten dhe figuren e prokurorit.
3. Prokuroret e tjere emerohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikes me propozim te Prokurorit te Pergjithshem.
4. Prokuri i Pergjithshem informon here pas here Kuvendin per gjendjen e kriminalitetit.

## PJESA E NJËMBËDHJETË: REFERENDUMI

Neni 150

1. Populli, nepermjet 50 mije shtetasve me te drejte vote, ka te drejten e referendumit per shfuqizimin e nje ligji, si dhe t'i kerkoje Presidentit te Republikes zhvillimin e referendumit per ceshtje te nje rendesie te vecante.
2. Kuvendi, me propozim e jo me pak se nje se pestes se deputeteve ose me propozimin e Keshillit te Ministrave, mund te vendose qe nje qe nje ceshtje ose nje projektligji nje rendesie te vecante te shtrohet ne referendum.
3. Parimet dhe procedurat per zhvillimin e referendumit, si dhe vlefshmeria e tij parashikohen me ligj.

Neni 151

1. Ligji i miratuar me referendum shpallet nga Presidenti i Republikes.
2. Ceshtjet qe lidhen me teresine territoriale te Republikes se Shqiperise, me kufizimin e lirive dhe te drejtave themelore te njeriut, me buxhetin , taksat e detyrimet financiare te shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes se jashtezakonshme, me deklarimin e luftes dhe te paqes dhe me amnistine nuk mund te shtrohen ne asnje referendum.
3. Referendumi per te njejten ceshtje nuk mund te perseritet perpara se te kete kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

Neni 152

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetueshmerine e ceshtjeve te shtruara per referendum sipas nenit 150 paragrafet 1 e 2, nenit 151 paragrafet 2 e 3 edhe sipas nenit 177 paragrafet 4 e 5 brenda 60 diteve.
2. Rendesia e ceshtjeve te vecanta, te parashikuara ne nenin 150 paragrafet 1 e 2 nuk eshte objekt gjykimi ne Gjykaten Kushtetuese.
3. Data referendumit caktohet nga Presidenti i Republikes brenda 45 diteve pas shpalljes se vendimit pozitiv te Gjykates Kushtetuese ose pas kalimit te afatit brenda te cilit Gykata Kushtetuese duhet te shprehej. Gjate vitit referendumet zhvillohen vetem ne nje dite.

## PJESA E DYMBËDHJETË: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Neni 153

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve eshte nje organ i perhershem qe pergatit, mbikeqyr drejton dhe verifikonte gjitha aspektet qe kane te bejne me zgjedhjet dhe me referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

Neni 154

1. Komisioni perbehet nga 7 anetare, te cilet zgjidhen per nje mandat 7-vjecar. Dy anetare zgjidhen nga Kuvendi, 2 nga Presidenti i Republikes dhe 3 anetare te tjere nga Keshilli i Larte i Drejtesise.
2. Perberja e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve perterihet cdo tre vjet sipas procedures se percaktuar me ligj.
3. Anetaresia ne Komision nuk pajtohet me asnje veprimtari tjeter shteterore dhe politike.
4. Subjektet elektorale caktojne perfaqesuesit e tyre prane Komisionit. Ata nuk kane te drejte vote.
5. Anetari i Komisionit gezon imunitetin e anetarit te Gjykates se Larte.
6. Komisioni ka buxhetin e vet.

## PJESA E TREMBËDHJETË: FINANCAT PUBLIKE

Neni 155

Taksat, tatimet dhe detyremet financiare kombetare e vendore, lehtesimi ose perjashtimi prej tyre i kategorive te caktuara te paguesve, si dhe menyra e mbledhjes se tyre caktohen me ligj. Ne keto raste ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese.

Neni 156

Shteti mund te marre e te garantoje hua dhe kredi financiare, kur autorizohet me ligj.

Neni 157

1. Sistemi buxhetor perbehet nga buxheti i shtetit dhe nga buxhetet vendore.
2. Buxheti i shtetit krijohet nga te ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve te tjera financiare, si dhe nga te ardhura te tjera te ligjshme. Ai perfshin te gjitha shpenzimet e shteti.
3. Organet vendore caktojne dhe mbledhin taksa dhe detyrime te tjera sic percaktohet me ligj.
4. Organet shteteroe dhe ato vendore jane te detyruara t'i bejne publike te ardhurat dhe shpenzimet.

Neni 158

1. Kryeministri, ne emer te Keshillit te Ministrave, i paraqet Kuvendit projektligjin per buxhetin e shtetit gjate sesionit te vjeshtes, i cili nuk mund te mbyllet pa e miratuar ate.
2. Ne qofte se projektligji nuk arrin te miratohet deri ne fillim te vitit te ardhshem financiar, Keshilli i Ministrave zbaton cdo muaj nje te dymbedhjeten e buxhetit te vitit paraardhes, derisa te miratohet buxheti i ri.
3. Kuvendi miraton buxhetin e ri brenda 3 muajve nga dita e mbarimit te vitit te kaluar financiar, pervecse ne rastet e vendosjes se masave te jashtezakonshme.
4. Keshilli i Ministrave eshte i detyruar t'i paraqese raport Kuvendit lidhur me zbatimin e buxhetit dhe me borxhin shteteror per vitin e kaluar.
5. Kuvendi vendos perfundimisht pasi degjon edhe raportin e Kontrollit te Larte te Shtetit.

Neni 159

Parimet dhe procedurat per hartimin e projektbuxhetit, si dhe per zbatimin e buxhetit percaktohen me ligj.

Neni 160

1. Gjate vitit financiar Kuvendi mund te beje ndryshime ne buxhet.
2. Ndryshimet ne buxhet behen sipas procedures se parashikuar per hartimin dhe miratimin e vete buxhetit.
3. Shpenzimet e parashikuara me ligje te tjera nuk mund te ulen sa kohe qe keto ligje jane ne fuqi.

Neni 161

1. Banka Qendrore e shteti eshte Banka e Shqiperise. Ajo kate te drejten ekskluzive te nxjerrjes e te qarkullimit te monedhes shqiptare, te zbatimit te pavarur te politikes monetare dhe te mbajtjes e te administrimit te rezervave te Republikes se Shqiperise.
2. Banka e Shqiperise drejtohet nga nje keshill, i cili kryesihet nga Guvernatori,.Guvernatori zgjidhet nga Kuvendi me propozim te Presidentit te Republikes per 7 vjet, me te drejte rizgjedhjeje.

**PJESA E KATËRMBËDHJETË: KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Neni 162

1. Kontrolli i Larte i Shtetit eshte institucioni me i larte i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nenshtrohet vetem Kushtetutes dhe ligjeve.
2. Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim te Presidenti te Republikes. Ai qendron ne detyre per 7 vjet, me te drejte rizgjedhjeje.

Neni 163

Kontrolli i Larte i Shtetit kontrollon:
a) veprimtarine ekonomike te institucioneve shteterore e te personave te tjere juridike shteterore;
b) perdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shteterore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor;
c) veprimtarine ekonomike te personave juridike, ne tecilet shteti ka me shume se gjysmen e pjeseve ose te aksioneve, ose kur huat, kredite dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Neni 164

1. Kontrolli i Larte i Shtetit i paraqet Kuvendit:
a) raport per zbatimin e buxhetit te shtetit;
b) mendim per raportin e Keshillit te Ministrave per shpenzimet e vitit te kaluar financiar para se te miratohet nga Kuvendi;
c) informacion per rezultatet e kontrolleve sa here qe kerkohet nga Kuvendi.
2. Kontrolli i Larte i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor te veprimtarise se tij.

Neni 165

1. Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit mund te ftohet te marre pjese dhe te flase ne mbledhjet e Keshillit te Ministrave, kur shqyrtohen ceshtje qe lidhen me funksionet e tij.
2. Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit te Gjykates se Larte.

**PJESA E PESËMBËDHJETË: FORCAT E ARMATOSURA**

Neni 166

1. Shtetasit shqiptare kane per detyre te marrin pjese pjese ne mbrojtjen e Republikes se Shqiperise, sic parashikohet ne ligj.
2. Shtetasi qe, per arsye ndergjegjeje, nuk pranon sherbimin me arme ne forcat e armatosura, eshte i detyruar te kryeje nje sherbim alternativ, sic parashikohet ne ligj.

Neni 167

1. Ushtaraket e sherbimit aktiv nuk mund te zgjidhen ose te emerohen ne detyra te tjera shteterore dhe as te marrin pjese ne parti ose ne veprimtari politike.
2. Pjesetaret e forcave te armatosura ose personat qe kryejne sherbimin alternativ, gezojne te gjitha te drejtat dhe lirite kushtetuese, pervec rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 168

1. Forcat e Armatosura te Republikes se Shqiperise perbehen nga forcat tokesore, detare dhe ajrore.
2. Presidenti i Republikes eshte Komandanti i Pergjithshem i Forcave te Armatosura.
3. Keshilli i Sigurimit Kombetar eshte organ keshillimor i Presidentit te Republikes.

Neni 169

1. Presidenti i Republikes, ne kohe paqeje, ushtron drejtimin e Forcave te Armatosura nepermjet Kryeministrit dhe ministrit te Mbrojtjes.
2. Presidenti i Republikes, ne kohe lufte , emeron dhe shkarkon Komandantin e Forcave te Armatosura me propozim te Kryeministrit.
3. Presidenti i Republikes, me propozim te Kryeministrit, emeron dhe shkarkon Shefin e Shtabit te Pergjithshem, si dhe, me propozim te ministrit te Mbrojtjes, emeron dhe shkarkon komandantet e forcave tokesore, detare dhe ajrore.
4. Kompetencat e Presidentit te Republikes si Komandat i Pergjithshem i Forcave te Armatosura dhe ato te Komandit te Forcave te Armatosura dhe varesia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj.

---

## PJESA E GJASHTËMBËDHJETË: MASAT E JASHTËZAKOMSHME

Neni 170

1. Masat e jashtezakonshme mund te vendosen per shkak te gjendjes se luftes, gjendjes se jashtezakonshme ose gjendjes se fatkeqesise natyrore dhe zgjatin per aq kohe sa vazhdojne keto gjendje.
2. Parimet e veprimtarise se organeve publike dhe shkalla e kufizimit te te drejtave dhe lirive te njeriut gjate gjithe periudhes se ekzistences se gjendjeve qe kerkojne marrjen e masave te jashtezakonshme, percaktohen me ligj.
3. Ligji duhet te percaktoje parimet, fushat dhe menyren e kompensimit te humbjeve qe vijne si rezultat i kufizimit te te drejtave dhe lirive gjate marrjes se masave te jashtezakonshme.
4. Aktet qe ndermerren si pasoje e marrjes se masave te jashtezakonshme, duhet te jene ne perpjestim me shkallen e rrezikut dhe duhet te synoje rivendosjen sa me te shpejte te kushteve per funksionimin normal te shtetit.
5. Gjate gjendjeve qe kerkojne marrjen e masave te jashtezakonshme, nuk mund te ndryshohet asnje prej ketyre akteve:Kushtetuta, ligjet per zgjedhjet per Kuvendin dhe per organet e pushtetit vendor, si dhe ligjet per masat e jashtezakonshme.
6. Gjate periudhes se zbatimit te masave te jashtezakonshme nuk mund te zhvillohen zgjedhje vendore, nuk mund te zhvillohet referendum, si dhe nuk mund te zgjidhet nje President i ri i Republikes. Zgjedhjet vendore mund te behen vetem aty ku nuk zbatohen masat e jashtezakonshme.

Neni 171

1. Ne rast agresioni te armatosur kunder Republikes se Shqiperise, Presidenti i Republikes, me kerkese te Keshillit te Ministrave, shpall gjendjen e luftes.
2. Ne rast kercenimesh te jashtme ose kur detyrimi per mbrojtje te perbashket buron nga nje marreveshje nderkombetare, Kuvendi, me propozim te Presidentit te Republikes, shpall gjendjen e luftes, vendos gjendjen e mobilizimit dhe te cmobilizimit te pergjithshem ose te pjesshem.

Neni 172

1. Ne rastin e nenit 171 paragrafi 1, Presidenti i Republikes i paraqet Kuvendit dekretin per vendosjen e gjendjes se luftes brenda 48 oreve nga nenshkrimi i tij, duke specifikuar te drejtat qe kufizohen.
2. Kuvendi merr ne shqyrtim menjehere dhe vendos me shumicen e te gjithe anetareve per dekretin e Presidentit.

Neni 173

1. Ne rast rreziku per rendin kushtetues dhe per sigurine publike, Kuvendi, me kerkese te Keshillit te Ministrave, mund te vendose ne nje pjese ose ne te gjithe territorin e shtetit gjendjen e jashtezakonshme, e cila zgjat per aq kohe sa vazhdon rreziku, por jo me shume se 60 dite.
2. Me vendosjen e gjendjes se jashtezakonshme nderhyrja e forcave te armatosura behet me vendim te Kuvendit dhe vetem kur forcat e policise nuk jane ne gjendje te rivendosin rendin.
3. Zgjatja e afatit te gjendjes se jashtezakonshme mund te behet vetem me pelqim te Kuvendit cdo 30 dite, per nje periudhe jo me shume se 90 dite.

Neni 174

1. Per parandalimin ose menjanimin e pasojave te nje fatkeqesie natyrore ose aksidenti teknologjik. Keshilli i Ministrave mund te vendose, per nje periudhe jo me te gjete se 30 dite gjendjen e jashte e fatkeqesise natyrore ne nje pjese ose ne te gjithe territorin e shtetit.
2. Zgjatja e gjendjes se fatkeqesise natyrore mund te behet vetem me pelqimin e Kuvendit.

Neni 175

1. Gjate gjendjes se luftes ose gjendjes se jashtezakonshme nuk mund te kufizohen te drejtat dhe lirite e parashikuara nga nenet :15, 18,19,20,21,24,25,29,30,31,32,34,39 paragrafi 1, 41 paragrafet 1, 2, 3 dhe 5, 42, 43, 48, 54, 55.
2. Gjate gjendjes se fatkeqesise natyrore mund te kufizohen te drejtat dhe lirite e parashikuara nga nenet : 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51.
3. Aktet per shpalljen e gjendjes se luftes, gjendjes se jashtezakonshme ose te gjendjes se fatkeqesive natyrore duhet te cilesojne te drejtat dhe lirite qe kufizohen sipas paragrafeve1 dhe 2 te ketij neni.

Neni 176

Kur Kuvendi nuk mund te mblidhet gjate gjendjes se luftes, Presidenti i Republikes, me propozim te Keshillit te Ministrave, ka te drejte te nxjerre akte qe kane fuqine e ligjit, te cilat duhet te miratohen nga Kuvendi ne mbledhjen e tij me te pare.

---

## PJESA E SHTATËMBËDHJETË: RISHIKIMI I KUSHTETUTËS

Neni 177

1. Nisma per rishikimin e Kushtetutes mund te ndermerret nga jo me pak se nje e pesta e anetareve te Kuvendit .
2. Asnje rishikim i Kushtetutes nuk mund te ndermerret gjate kohes kur jane vendosur masat e jashtezakonshme.
3. Projekti miratohet nga jo me pak se dy te tretat e te gjithe anetareve te Kuvendit.
4. Kuvendi mund te vendose, me dy te tretat e te gjithe anetareve te tij, qe projektamendamentet kushtetuese te votohen me referendum. Projektligji per rishikimin e Kushtetutes hyn ne fuqi pas ratifikimit me referendum, i cili behet jo me vone se 60 dite nga miratimi i tij ne Kuvend.
5. Amendamenti kushtetues i miratuar i nenshtrohet referendumit, kur kete e kerkon nje e pesta e te gjithe anetareve te Kuvendit.
6. Presidenti i Republikes nuk kate drejte ta ktheje per rishqyrtim ligjin e miratuar nga Kuvendi per rishikimin e Kushtetutes.
7. Ligji i miratuar ne referendum shpallet nga Presidenti i Republikes dhe hyn ne fuqi ne daten e parashikuar ne kete ligj.
8. Rishikimi i Kushtetutes per te njejten ceshtje nuk mund te behet perpara se te kete kaluar nje vit nga dita e rrezimit te projektligjit ne Kuvend dhe jo me perpara se te kene kaluar 3 vjet nga dita e rrezimit te tij ne referendum.

---

## PJESA E TETËMBËDHJETË: DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 178

1. Ligjet dhe aktet e tjera normative te miratuara para dates se hyrjes ne fuqi te kesaj Kushtetute do te zbatohen derisa nuk jane shfuqizuar.
2. Keshilli i Ministrave i paraqet Kuvendit projektligjet e nevojshme per venien ne zbatim te kesaj Kushtetute.

Neni 179

1. Mandati i organeve kushtetuese qe do te ekzistojne me hyrjen ne fuqi te kesaj Kushtetute mbaron me afatet e parashikuara ne ligjin nr.7491, date 29.04.1991 "per dispozitat kryesore kushtetuese", me ndryshimet dhe plotesimet perkatese.
2. Anetaret e Gjykates se Kasacionit vazhdojne veprimtarine e tyre si anetare te Gjykates se Larte, sipas mandatit te meparshem.
3. Anetaret e Keshillit te Larte te Drejtesise te zgjedhur nga radhet e prokuroreve zevendesohen me anetare te rinj te zgjedhur nga mbledhja e pergjithshme e gjyqtareve.
4. Organet e pushtetit vendor vazhdojne veprimtarine deri ne mbarim te mandatit te tyre.

Neni 180

1. Marreveshjet nderkombetare te ratifikuara nga Republika e Shqiperise para hyrjes ne fuqi te kesaj Kushtetute konsiderohen te ratifikuara sipas kesaj Kushtetute.
2. Keshilli i Ministrave i paraqet Gjykates Kushtetuese marreveshjet nderkombetare, te cilat permbajne dispozita qe vijne ne kundershtim me kete Kushtetute.

Neni 181

1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjeteve nga hyrja ne fuqi e kesaj Kushtetute nxjerr ligje per rregullimin e drejte te ceshtjeve te ndryshme qe lidhen me shpronesimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit te kesaj Kushtetute, duke u udhehequr nga kriteret e nenti 41.
2. Ligjet dhe aktet e tjera normative te miratuara para dates se hyrjes ne fuqi te kesaj Kushtetute dhe qe kane te bejne me shpronesimet dhe konfiskimet, do te zbatohen kur nuk vijne ne kundershtim me te.

Neni 182

Ligji nr.7491, date 29.04.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese"' si dhe ligjet e tjera kushtetuese shfuqizohen diten e hyrjes ne fuqi te kesaj Kushtetute.

Neni 183

Kjo Kushtetute hyn ne fuqi me shpalljen nga Presidenti i Republikes.